

Nxirrini përgjegjesit për torturimin a djalit të Iraci Oliveira dos Santos para gjyqit.

Pesëmbëdhjetëvjeçari José (nuk është emri i tij e vërtetë) ishte arrestuar në qershor të vitit 1999 dhe ishte mbajtur në arrest për dy ditë. Gjatë kësaj kohe ai ishte rrahur keq nga policët në rroba civile dhe që atëherë është nën përujdesje psikiatrike. Raportet e fundit thonë se José është ende nën trajtim mjekësor si rezultat i lëndimeve që kishte marrë në testiset e tij gjatë rrahjes.

José kishte dalë nga shtëpia tij në Xinguara, shteti Pará, pasditën e 7 qershorit për të shkuar në tombol me shokë. Nëna e tij, Iraci Oliveira dos Santos, filloi të bëhej merak kur ai nuk u kthye atë natë në shtëpi. Ajo shkoi ta kërkojë atë në spital para se të shkontë në polici. Atje i thanë se ai ishte ndaluar nga policia.

Pas pritjes disaorëshe, asaj i kishin lejuar të shihte djalin e saj, José, mbrëmjen e 8 qershorit. Ajo thot se e kishte gjetë atë në dhembje të mëdha ndërsa trupin e kishte të tërin të mavijosur. Një nga çunat i cili gjithashtu mbahej në burg i kishte thënë asaj se José ishte keqtrajtuar mbrenda dhe jasht stacionit të policisë dhe se ajo do të bënte mirë po ta nxirrte djalin e saj që andej sa më parë.

José i kishte thënë nënës së tij se policia e kishte përcjellë prej momentit kur kishte dalë nga shtëpia. Ai ishte frikësuar dhe ishte rrëzuar nga motoçikleta. Policët ishin ndalur, kishin drejtuar revolet drejt tij dhe e kishin shqelmuar e kërcënuar se do ta vrisnin. Pastaj ata e kishin dërguar atë në një vend të panjohur ku e kishin kërcënuar përsëri se do ta vrisnin. Më në fund e kishin dërguar në stacionin e policisë dhe e kishin akuzuar për posedim të një sasive të vogël të kanabisit dhe të një revoleje të vogël. Në mbrëmje, policët e kishin nxjerrë José në korridor të stacionit të policisë dhe e kishin rrahur përsëri. Çunat tjerë që mbareshin në stacionin e policisë thonë se ai ishte rrahur aq keq sa ata kishin menduar se ai do të vdiste. José ishte detyruar të pranojë se ishte arrestuar disa herë përpara megjithëse kjo nuk ishte e vërtetë.

Me 9 Qershor Iraci Oliveira dos Santos u përpoq të takoj shefin e policisë në lidhje me mbajtjen e djalit të saj, por ai refuzoi ta takonte, duke thënë se ajo ishte sjellë keq me policët e tij. Policët ia kishin bërë të ditur asaj përmes miqve se ajo mund ta mirrte djalin e saj me kusht që të mos ankohej për keqtrajtimin e tij. Nga dëshira për të siguruar trajtim mjekësor për djalin e saj, ajo kishte pranuar.

Që nga lirimi i tij, José vuan nga probleme psikologjike dhe është shtruar në një institucion psikiatrik në disa raste për periudha një ose dy muajshe. Pas festave të vitit të ri, të cilat ai i kishte kaluar me prindërit e tij, gjendja e tij mentale ishte keqësuar në mënyrë dramatike. Ai ishte dërguar përsëri në spital psikiatrik në 16 qershor 2000 dhe vazhdon të mbahet aty si pacient.

Edhe pse José ishte liruar nga arresti policor me kusht që Iraci Oliveira dos Santos të mos ankohej për trajtimin e djalit të saj, ajo ka bërë një ankesë formale te Prokurori Publik. Prokurori Publik e ka referuar rastin për hetime të njëjti shef policie i cili komandon stacionin e policisë ku është torturuar José. Iraci Oliveira dos Santos është indinjuar aq shumë me mënyrën se si është trajtuar djali i saj sa që ka ndërmarrë një hap të rrallë dhe të guximshëm. Ajo e ka publikuar rastin në Brazil dhe është paraqitur në television. Ka pasur raporte të shumta mbi brutalitetin policor në Xinguara, nga të cilat vetëm disa janë hetuar, në të shumtën e rasteve për arsye se viktimat dhe dëshmitarët kanë pasur frikë të paraqiten.

Republika Popullore e Kinës

Abdulhelil Abdumijit është arrestuar më 5 shkurt 1997 në qytetin Gulja, Regioni Autonom i Xinjiang Uighur (XUAR). Policia pastaj e kishte rrahur dhe e kishte dërguar në një burg lokal. Aty ai është torturuar për ta detyruar të pranojë "krimet" që kishte bërë dhe t'i denoncojë shokët e tij. Ai ishte detyruar të drejtohet nga muri dhe ishte rrahur shpinës. Një zyrtar ka konfirmuar se Abdulhelil Abdumijit është ndaluar nën dyshim se ka udhëhequr një demonstratë, por autoritetet nuk kanë dhënë ndonjë informacion tjetër në lidhje me të. Është raportuar se ai mbahet në një burg nën kontrollin e Divizionit të Katërt të Korpusit për Ndërtim dhe Prodhim (Bingtuan) të Xinjiang jashtë qytetit Gulja. Atje, ai vazhdon të keqtrajtohet; një i burgosur e kishte parë një gardian duke e ndërsyer qenin në të.

Abdulhelil Abdumijit, tregtar rrugësh, është një nga qindra njerëz që dolën në rrugë të qytetit Gulja më 5 February 1997. Demonstruesit mbanin pllakate dhe bërtisnin shlogane duke kërkuar t'i jipet fund diskriminimit të Uighurëve etnikë. Sipas raporteve, pas disa orësh demonstrimi paqësor, policë të armatosur kishin ardhë dhe kishin burgosur rreth 500 njerëz. Të nesërmen, në Gulja ishte shpallur orë policore, njësitë speciale ishin mobilizuar dhe qyteti ishte izoluar nga bota për dy javë. Protestat sporadike dhe demonstrimet kishin vazhduar për disa ditë. Një numër i madh i njerëzve ishin vrarë ose lënduar në confrontimet në mes policisë dhe protestuesve dhe besohet se mijëra protestues ishin arrestuar.

Veçanërisht shqetësuese janë raportet mbi trajtimin brutal të njerëzve që mbahen në Gulja mbas protestave të shkurtit 1997 dhe mbi përdorimin e disa formave të torturës në XUAR të cilat, me sa është në dijeni Amnesty International, nuk përdoren tjetërkund në Kinë. Ka shumë pak raporte për ndjekjet e personave që kanë përdorë torturimin në XUAR — për ndryshim nga pjesët tjera të Kinës. Kjo dëshmon se autoritetet ose janë duke injoruar dhe fshehur torturimet e shpeshta në region, ose e kanë urdhëruar përdorimin e dhunës në funksion të represionit.

Deri në vitin 1949 populli Uighur, shumica e të cilëve janë muslimanë, përbënin shumicën në XUAR. Tani ata përbëjnë më pak se gjysmën e popullatës. Zhvillimi ekonomik në vend i viteve të fundit nuk është pasqyruar në popullatën Uighure, të cilët ankohen për diskriminim në arsim dhe sistemin shëndetësor. Papunësia gjithashtu kapë një shkallë të lartë. Në të njëjtën kohë, politika qeveritare ka reduktuar në mënyrë sistematike të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të popullit Uighur. Që nga fundi i viteve 1980, qeveria ka vendosur kufizime mbi aktivitetet fetare. Shumë xhami dhe shkolla fetare janë mbyllur, ndërsa muslimanët të cilët punojnë në institucione qeveritare e kanë të ndaluar të praktikojnë fenë e tyre.

Format e torturës më së shpeshti të raportuara në XUAR përfshijnë rrahjen dhe shqelmimin, përdorimin e shkopinjëve elektrikë, përdorimin e prangave, zingjirëve dhe litarit për të lidhur të burgosurit në pozitë të tillë që shkakton dhimbje maksimale; dhe nënshtrimi temperaturave ekstreme të larta ose të ulëta. Llojet tjera të torturës të raportuara në XUAR, por që nuk përmenden në pjesët tjera të vendit, përfshijnë përdorimin e injeksioneve të paidentifikuara të cilat të viktima shkaktojnë humbjen e balansit mental ose të aftësisë së të folurit; futjen e biberit ose specit të djegës në gojë, hundë, ose organet gjinitale; dhe futjen e qimeve të kalit ose telit në penis.